



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025 | Nr: 125 | Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 37 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 125.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/3 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nëpërmjet marrjes në punë para fushatës zgjedhore.

BAZA LIGJORE: Nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 37 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është publikuar njoftim për shpalljen e procedurave për plotësimin e vendeve të lira të kategorisë së lartë drejtuese në Bashkinë Maliq. Në mënyrë specifike vendet vakante konsistojnë në:

- Sekretar i Përgjithshëm (1 pozicion);
- Drejtor në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Aseteve (1 pozicion);

Data: 20.02.2025

Nr: 125
Ora: 00:00



“Për mosfillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 37 ID, datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

- *Përgjegjës sektori në Sektorin e Prokurimeve dhe Menaxhimit të Kontratave (1 pozicion);*
- *Përgjegjës Zyre në Zyrën Këshillimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (1 pozicion);*
- *Përgjegjës Zyre në Sektorin e Shërbimeve Sociale (1 pozicion);*
- *Agronom (1 pozicion);*
- *Specialist Koordinimi Donatore (1 pozicion);*
- *Nënpunës Finance Protokoll (3pozicion);*
- *Specialist Arkitekt Dizanj (1 pozicion);*
- *Specialist Auditi (1 pozicion);*
- *Specialist Inxhinier (1 pozicion);*
- *Specialist/Jurist (1 pozicion);*
- *Specialist Programues Bazë të dhënash (1 pozicion);*
- *Specialist Statisticien (1 pozicion).”*

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillim të procedurës administrative për denoncimin nr. 37 ID, datë 18.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI